*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të*
*Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*
*Dt.23.05.2023*

**23.05.2023**
**Ora 15:10**

*RENDI I DITËS*

***Projektvendim "Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për disa këshilla bashkiak, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".***

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - **1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** — **Z. Ilirjan Celibashi**
  - **2. Stafi KQZ:** — **Z. Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:** — **PDIU**
- **Të tjerë:** — **KRIIK**

***Z. I. Celibashi***: Kalojmë te projktvendimet që lidhen me shpërdarjen e mandateve për çdo subjekt zgjedhor për votimin për këshillin bashkiak.

***Z. Y. Merkaj:*** Faleminderit! Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja "i" e Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për këshillat vendorë, si dhe jep mandatet për çdo kryetar bashkie, territori i të cilave është ndarë në më shumë se një ZAZ. Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor, Bashkia Libohovë, Fusharrëz, Vorë, Divjakë, Poliçan, Skrapar, Puctec, Këlcyrë, Tepelenë, Sarandë, Delvinë dhe Konispol kanë miratuar tabelat përmbledhëse të rezultatit, përkatësisht sipas KZAZ-ve përkatëse dhe kundër këtij vendimi nuk ka patur ankim në komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Rezultati për këshillat bashkiak të bashkivë të mesipërme dhe renditja e subjekteve zgjedhore

është bërë sipas nenit 162 pika 1 dhe pika 4 e Kodit Zgjedhor si dhe përfundimin e shpërndarjes së mandateve sipas tabelës 4 bashkëlidhur këtyre vendimeve. Sipas nenit 163, 166 pika 3, të Kodit Zgjedhor, menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit si më sipër, KQZ-ja përllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt, në bazë të renditjes në listat shumemërore të subjekteve zgjedhore të miratuara nga KZAZ-ja. Bashkëlidhur keni vendimin për shqyrtim dhe miratim të këtyre KZAZ-ve. Faleminderit!

***Z. I. Celibashi***: Faleminderit! Atëherë, për Bashkinë Libohovë numri i mandateve që ka fituar çdo subjekt zgjedhor për anëtar këshilli është si vijon:
- Koalicioni Bashkë Fitojmë 5.
- Partia Socialiste e Shqipërisë 8 mandate.
- Partia Demokratike 2 mandate.

Njëkohësisht bashkëlidhur këtij vendimi janë dhe emrat e kandidatëve fitues për anëtar këshilli për secalin prej këtyre 3 subjekteve.

Shpërndarja e vendeve në këshill për Bashkinë Fusharrëz është si vijon:
- Koalicioni Bashkë Fitojmë 1 mandat.
- Partia Socialiste e Shqipërisë 2 mandate.
- Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë 3 mandate.
- Aleanca Liberale e Djathtë 1 mandat.
- Partia Socialdemokrate 3 mandate.
- Partia Demokratike 1 mandat.
-Fryma e Re Demokratike 1 mandat.
- Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet 1 mandat.
- Partia Kristian Demokrate 2 mandate.

Shpërndarja e vendeve në këshill për Bashkinë e Vorës është si vijon:

- Bashkë Fitojmë 4 mandate.
- Partia Socialiste e Shqipërisë 13 mandate.
- Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë 2 mandate.
- Partia Republikane Shqiptare 1 mandat.
- Fryma e Re Demokratike 1 mandat.

Shpërndarja e vendeve në këshill për Bashkinë Divjakë është si vijon:

-Bashkë Fitojmë 5 mandate.
- Partia Socialiste e Shqipërisë 18 mandate.
- Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë 1 mandat.
- Partia Republikane Shqiptare 1 mandat.
- Partia Levizja e Legalitetit 1 mandat.
- Partia Socialdemokrate 1 mandat.
- Partia Demokratike 4 mandate.

Shpërndarja e vendeve në këshill për Bashkinë Poliçan është si vijon:

- Bashkë Fitojmë 1 mandat.
- Partia Socialiste e Shqipërisë 13 mandate.
- Partia Demokratike 1 mandat.

Shpërndarja e vendeve në këshill për Bashkinë Skrapar është si vijon:

- Bashkë Fitojmë 5 mandate.
- Partia Socialiste e Shqipërisë 8 mandate.
- Partia Republikane Shqiptare 1 mandat.
- Partia Socialdemokrate 1 mandat.

Shpërndarja e vendeve në këshill për Bashkinë Pustec është si vijon:

- Bashkë Fitojmë 4 mandate.
- Partia Socialiste e Shqipërisë 5 mandate.
- Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë 1 mandat.
- Partia Demokracia Sociale 1 mandat.
- Partia Socialdemokrate 1 mandat.
- Aleanca Maqedonasve për integrimin Europian 3 mandate.

Shpërndarja e vendeve në këshill për Bashkinë Këlcyrë është si vijon:

-Bashkë Fitojmë 1 mandat.
- Partia Socialiste e Shqipërisë 3 mandate.
- Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë 1 mandat.
- Partia Republikane Shqiptare 1 mandat.
- Aleanca Liberale e Djathtë 1 mandat.
- Partia Socialdemokrate 1 mandat.
- Partia Demokratike 1 mandat.
- Aleanca Progresiste L.ZH.K 1 mandat.
- Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet 1 mandat.
- Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë 1 mandat.
- Lëvizja e RE 1 mandat.
- Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë 1 mandat.
- Ardhmërija Shqiptare 1 mandat.

Shpërndarja e vendeve në këshill për Bashkinë Tepelenë është si vijon:

- Bashkë Fitojmë 1 mandat.
- Partia Socialiste e Shqipërisë 11 mandate.
- Partia Republikane Shqiptare 1 mandat.
- Partia Socialdemokrate 1 mandat.
- Partia Demokratike 1 mandat.

Shpërndarja e vendeve në këshill për Bashkinë Sarandë është si vijon:

- Bashkë Fitojmë 4 mandate.
- Partia Socialiste e Shqipërisë 12 mandate.
- Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë 1 mandat.
- Partia Republikane Shqiptare 2 mandate.
- Partia Levizja e Legalitetit 2 mandate.
- Partia Demokratike 3 mandate.
- Fryma e Re Demokratike 1 mandat.
- Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet 2 mandate.
- Aleanca Arbnore Kombëtare 2 mandate.
- Partia Balli Kombëtar 1 mandat.
- Ibrahim Skënder Bajrami 1mandat.

Shpërndarja e vendeve në këshill për Bashkinë Delvinë është si vijon:

- Bashkë Fitojmë 3 mandate.
- Partia Socialiste e Shqipërisë 8 mandate.
- Partia Socialdemokrate 3 mandate.
- Partia Demokratike 1 mandat.

Shpërndarja e vendeve në këshill për Bashkinë Konispol është si vijon:

- Bashkë Fitojmë 3 mandate.
- Partia Socialiste e Shqipërisë 7 mandate.
- Partia Republikane Shqiptare 1 mandat.
- Partia Levizja e Legalitetit 1 mandat.
- Partia Demokratike 1 mandat.
- Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet 2 mandate.

**Vendimet nr. 546 - 557**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të*
*Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*
*Dt.23.05.2023*

**23.05.2023**
**Ora 15:19**

***RENDI I DITËS***

***<u>Projektvendim "Për dhënien e mandateve për disa kryetarë bashkie, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".</u>***

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**

| | |
|---|---|
| **1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** | **Z. Ilirjan Celibashi** |
| **2. Stafi KQZ:** | **Z. Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj** |
| • **Parti Politike:** | **PDIU** |
| • **Të tjerë:** | **KRIIK** |

***Z. I. Celibashi***: Vazhdojmë me projektvendimin që lidhet me dhënien e mandatit të kryetarëve të bashkive.

***Z. Y. Merkaj:*** Referuar nenit 166, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, kryetar bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse. Bazuar në nenin 33, shkronja "g" të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor të Bashkisë Libohovë, Poliçan, Fusharrëz, Vorë, Divjakë, Skrapar, Pustec, Këlcyrë, Tepelenë, Sarandë, Delvinë dhe Konispol kanë shpallur fitues kandidatin, i cili ka marrë numrin më të madh të votave, bashkëlidhur dhe tabelave që i bashkëlidhen këtyre vendimeve. Për këtë arsye i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhënien e mandatit për kryetar bashkie të bashkive Libohovë, Poliçan,

Fusharrëz, Vorë, Divjakë, Skrapar, Pustec, Këlcyrë, Tepelenë, Sarandë, Delvinë dhe Konispol sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi. Bashkëlidhur keni projektvendimet për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

***Z. I. Celibashi***: Faleminderit! Edhe për keto nuk kemi patur ankim.

***Z. Y. Merkaj:*** Jo, kundër këtij vendimi nuk ka patur ankim.

***Z. I. Celibashi***: Mirë atëherë miratojmë dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Libohovë, zotit Leonard Hide, mbështetur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Poliçan zotit Adriatik Zotkaj, mbështetur nga Partia Socialiste; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Fusharrëz, zotit Hil Curri, mbështetur nga Koalicioni Bashkë Fitojmë; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Vorë, zotit Blerim Shera, mbështetur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Divjakë, zotit Josif Gorrea, mbështetur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Skrapar, zotit Adriatik Mema, mbështetur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Pustec zotit Pali Kolefski, mbështetur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Këlcyrë, zotit Klement Ndoni, mbështetur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, zotit Tërmet Peçi, mbështetur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, zotit Oltion Çaçi, mbështetur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Delvinë, zotit Besmir Veli, mbështetur nga subjekti zgjedhor Partia

Socialiste e Shqipërisë; Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Konispol, zotit Ergest Dule, mbështetur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Këto ishin të gjitha çështjet në rendin e ditës. Seanca mbyllet, faleminderit, ditë të mbarë!

**Vendimet nr. 558 - 569**

*Zbardhi materialin audio*
*Arlinda Bahollari*

**DATA 23.05.2023**
**Ora** 15:19.

**<u>Seancë publike e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve</u>**

**<u>RENDI I DITES</u>**

**<u>14.Projektvendim ""Për dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë, Bashkia Libohovë, z. Leonard Hide, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023".</u>**

**PJESEMARRJA:**

- **KQZ :**
  **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi i KQZ: Y. Merkaj, P. Doçaj**
- **PARTI POLITIKE:** PDIU.
- **Të tjerë: KRIIK**

z. I. Celibashi → Vazhdojmë.

z. Y. Merkaj → Relatori.

z. I. Celibashi – s'ka pas ankimi?

z. Y. Merkaj – Jo!

z. I. Celibashi → I japim mandatin Kryetarëve të B/Libohovë, Poliçan, Fushë-Arrëz, Vorë, Divjakë, Kavajë, Pustec, Këlcyrë, Tepelenë, Sarandë, Delvinë, Konispol. Seanca mbyllet! Vend. nr. [illegible]